



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Shtojca 5a: Struktura e pjesës narrative të raportit vjetor për konsultimet e kryera publike të ministrive dhe institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit

RAPORT VJETOR PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK PËR VITIN 2022 MINISTRIA E BUJQËSISË DHE E ZHVILLIMIT RURAL

1.Përmbledhia ekzekutive (pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2022, Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural (MBZHR) ka konsultuar 5 akte :

1. Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021-2027”.
2. Projektligji “Për përfundimin e procesit të privatizimit të objekteve të Ish -Ndërmarrjeve Bujqësore “
3. Projektligji “Për bletarinë”
4. Udhëzimi “Për rregullat për masat e veçanta të kontrollit për të parandaluar hyrjen dhe përhapjen brenda vendit të XYLELLA FASTIDIOSA (WELLS ET AL.) ”.
5. Urdhri "Për miratimin e planit të veprimit për përdorimin e qëndrueshëm të produkteve për mbrojtjen e bimëve në shqipëri për vitet 2022-2032"


Nga monitorimi i platformës së Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) vihet re se gjatë vitit 2022, ka patur 1464 vizitorë nga publiku. Ajo që identifikohet nga procesi i konsultimit i realizuar për vitin 2022, edhe pse vihet re një përmirësim i këtij procesi gjatë kësaj periudhe, është nevoja për informim më të mirë të publikut dhe pjesëmarrje më aktive e tij. Kjo përbën një ndër sfidat për t’u adresuar edhe më mirë nga institucioni ynë.

2.Analiza e konsultimeve të kryera

2.1 Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike

2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?

Për periudhën Janar – Dhjetor 2022 janë miratuar 31 akte, nga të cilat 5 akte janë objekt i Konsultimit Publik.



	Akte te parashikuara	Akte te miratuara
PPAP	18	12
PKIE	19	19
Dokumet Strategjik	1	1

2.1.2. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?

Janë konsultuar 5 (pesë) akte, konkretisht:

Projektvendimi “ Për miratimin e Strategjisë për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021-2027”, i cili ka rëndësi strategjike dhe sipas pikës 1, të Nenit 1 të ligjit “Për konsultimin Publik”, i nënshtrohet këtij procesi.

Projekligji “Për bletarinë”, sipas pikës 1, të Nenit 1 të ligjit “Për konsultimin Publik”, i nënshtrohet këtij procesi.

Projekligji “Për Përfundimin e procesit të privatizimit të objektveve të ish-Ndërmarrjeve Bujqësore”. sipas pikës 1, të Nenit 1 të ligjit “Për konsultimin Publik”, i nënshtrohet këtij procesi.

Udhëzimi “Për rregullat për masat e veçanta të kontrollit për të parandaluar hyrjen dhe përhapjen brenda vendit të XYLELLA FASTIDIOSA (WELLS ET AL.) ”.

Urdhri "Për miratimin e planit të veprimit për përdorimin e qëndrueshëm të produkteve për mbrojtjen e bimëve në shqipëri për vitet 2022-2032"

Ndërkohë aktet e miratuara ndahen si më poshtë:

- 2 ligje

Projektligji “Për bletarinë”, sipas pikës 1, të Nenit 1 të ligjit “Për konsultimin Publik”, i nënshtrohet këtij procesi.

Projektligji “Për Përfundimin e procesit të privatizimit të objektveve të ish-Ndërmarrjeve Bujqësore”. sipas pikës 1, të Nenit 1 të ligjit “Për konsultimin Publik”, i nënshtrohet këtij procesi.

- 15 VKM


14 VKM, të cilat sipas shkronjës “ç”, të Nenit 4, të Ligjit “Për konsultimin publik”, nuk i nënshtrohen këtij procesi duke përjashtuar projektvendimin “ Për miratimin e Strategjisë për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021-2027” “ i cili i është nënshtruar konsultimit për shkak të rëndësisë së tij.

- 1 urdhër Ministri

Urdhri "Për miratimin e planit të veprimit për përdorimin e qëndrueshëm të produkteve për mbrojtjen e bimëve në shqipëri për vitet 2022-2032"

- 1 udhëzim Ministri

Udhëzimi “Për rregullat për masat e veçanta të kontrollit për të parandaluar hyrjen dhe përhapjen brenda vendit të XYLELLA FASTIDIOSA (WELLS ET AL.) ”. (parashikuar ne PKIE 2022)



2.1.3. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?

Projektligjet e miratuara dhe të konsultuara për vitin 2022 i janë nënshtruar procesit të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator.

1. Projektligji “Për përfundimin e procesit të privatizimit të objekteve të Ish -Ndërmarrjeve Bujqësore “
2. Projektligji “Për bletarinë”

2.1.4. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përgjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyt kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?

Në PPAP e vitit 2022 janë parashikuar për miratim 18 projektakte, nga të cilat janë miratuar 12 akte (VKM). Nga aktet e miratuara, janë përdorur kriteret e përgjashtimit nga konsultimi publik:

- Për 11 projektvendime, në zbatim të shkronjës “ç”, të Nenit 4, të ligjit nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” dhe 1 projektvendim i cili i është nënshtruar Konsultimin Publik për shkak të rëndësisë që ka.

Në PKIE e viti 2022 janë parashikuar 19 akte. Gjatë 2022 janë miratuar 19 projektakte (1 ligj, 3 vkm, 8 urdhra dhe 7 udhëzime).

	Projektaktetë parashikuara	Projektakte të publikuara për konsultim	Projektakte jo të publikuara për konsultim	% e akteve të publikuara për konsultim
a)PPAP	18	3	15	16.6%
b)PKIE (për vitin 2022)	19	3	16	15.7 %
c) Dokumente strategjik të sektorit	1	1	7	100 %

2.1.5. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?

Është konsultuar një 1 projektvendim me rëndësi strategjike, 2 projektligje, 1 udhëzim dhe 1 urdhër me interes publik.

2.1.6. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?

Jemi të mendimit se situata lidhur me këtë proces është përmirësuar në krahasim me periudhën e mëparshme.

Procesi i krahasuar me vitin e mëparshëm është përmirësuar, lidhur me diversifikimin e mjeteve të përdorura për konsultim, rritjen e aksesit të qytetarëve në konsultim dhe në shkallën e reagimeve të

mbledhura

2.2. Metodatat e konsultimit

2.2.1. *Cilat ish-in metodatat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)*

Metodat e përdorura për konsultimin publik gjatë kësaj periudhe ish-in 3(tre):

1. Konsultimi në faqen zyrtare të konsultimit publik,
2. Tryeza të konsultimit me ekspertë/grupe interesi/teknike
3. Komunikim nëpërmjet postës elektronike.

Projektakti i konsultuar i është nënshtruar këtyre metodave të konsultimit

Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021-2027”. Hartimi i Strategjisë për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021 – 2027 ka filluar me ngritjen e Grupit të Punës me datë 5.2.2022 dhe është hartuar me mbështetjen e ekspertëve të GIZ. Kohëzgjatja e përgjithshme e hartimit të strategjisë përfshirë konsultimet e vazhdueshme gjatë hartimit dhe konsultimin publik ka qenë nga data 30.07.2021 deri më 04.05.2022. Në këtë afat përfshihen edhe takimet me grupet e interesit, komunikimet me postën elektronike edhe konsultimi përmes regjistrit elektronik. Duke qenë se procesi i hartimit të strategjisë ka qenë një proces dinamik dhe grupet e interesit që kanë qenë të përfshira në hartimin e dokumentit komentet/sugjerime të tyre janë marrë parasysh gjatë procesit të hartimit.

Projektligji “Për Bletarinë”.

Kohëzgjatja e përgjithshme e hartimit të projektligjit, përfshirë konsultimet e vazhdueshme gjatë hartimit dhe konsultimin publik ka qenë nga data 21.10.2021 deri më datë 8.11.2022. Në këtë afat përfshihen, takimet e grupit të punës, takimet dhe konsultimet me ekspertët e fushës, mendimet e Ministrive të Linjës, si edhe konsultimi përmes regjistrit elektronik RENJK, nga 24.4.2022 deri në datë 23.5.2022;

Projektligji “Për përfundimin e procesit të privatizimit të objekteve të ish-ndërmarrjeve bujqësore”.

Kohëzgjatja e përgjithshme e hartimit të projektligjit, përfshirë konsultimet e vazhdueshme gjatë hartimit dhe konsultimin publik ka qenë nga data 16.6.2021 deri më datë 17.12.2022. Në këtë afat përfshihen, takimet e grupit të punës, mendimet e Ministrive të Linjës, si edhe konsultimi përmes regjistrit elektronik RENJK, nga 4.4.2022 deri në datë 5.5.2022. Kjo metodë është përzgjedhur për shkak të natyrës teknike të nevojës për ndërhyrje në ligj.

2.2.2. *Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?*

Metoda që gjeneroi numrin më të madh të komenteve ishte ajo e tryezave të konsultimit/takimeve dhe email, ndërsa nga konsultimi publik nëpërmjet regjistrit elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike nuk kishte komente.

*2.2.3. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit?
Nëse po, në sa raste?*

Po janë realizuar konsultime paraprake për Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021-2027”. Hartimi i Strategjisë për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021 – 2027 ka filluar me ngritjen e Grupit të Punës me datë 5.2.2022 dhe është hartuar me mbështetjen e ekspertëve të GIZ. Kohëzgjatja e përgjithshme e hartimit të strategjisë përfshirë konsultimet e vazhdueshme gjatë hartimit dhe konsultimin publike ka qenë nga data 30.07.2021 deri më 04.05.2022. Në këtë afat përfshihen edhe takimet me grupet e interesit, komunikimet me postën elektronike edhe konsultimi përmes regjistrimit elektronik. Duke qenë se procesi i hartimit të strategjisë ka qenë një proces dinamik dhe grupet e interesit që kanë qenë të përfshira në hartimin e dokumentit komentet/sugjerime e tyre janë marrë parasysh gjatë procesit të hartimit.

Projektligji “Për Bletarinë”.

Hartimi i projektligjit ka filluar me ngritjen e grupit të punës në zbatim të urdhrit të ministrit Nr. 543 datë 23.10.2021 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e ligjit “Për bletarinë””, pjesë e të cilit kanë qenë përfaqësues nga shoqatat lokale të bletërritësve, AKU, Universiteti Bujqësor i Tiranës.

Kohëzgjatja e përgjithshme e hartimit të projektligjit, përfshirë konsultimet e vazhdueshme gjatë hartimit dhe konsultimin publik ka qenë nga data 21.10.2021 deri më datë 8.11.2022. Në këtë afat përfshihen, takimet e grupit të punës, takimet dhe konsultimet me ekspertët e fushës, mendimet e Ministrive të Linjës, si edhe konsultimi përmes regjistrimit elektronik RENJK, nga 24.4.2022 deri në datë 23.5.2022; Gjithashtu ky projektligj ka kaluar për konsultim me të gjithë ekspertët e fushës, përfshirë të gjitha shoqatat lokale të bletërritësve, si dhe profesorë të fushës së Universitetit Bujqësor, komentet e të cilëve janë bërë pjesë e projektaktit.

2.3. Kohëzgjatja e konsultimeve

2.3.1. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?

1. Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021-2027”. Kohëzgjatja e përgjithshme e konsultimeve ka zgjatur nga data 30.07.2021 deri më 04.05.2022.

2. Projektligji “Për Bletarinë”.

Kohëzgjatja e përgjithshme e konsultimeve ka zgjatur nga data data 24.4.2022 deri më datë 23.5.2022.

Konsultimet në RENJK kanë qenë të hapura për 20 ditë, pra u realizua nëpërputhje me ligjin nr.146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, përkatësisht me nenin 15 të tij. Konsultimet patën një kohëzgjatje prej 20 ditësh nga data e publikimit.

2.3.2. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit për projektaktet e miratuara gjatë vitit 2022, ishte 3 muaj.

2.3.3. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Në krahasim me vitin e kaluar situata nuk ka pasur përmirësime të dukshme të procesit të konsultimit përmes RENJK, pasi interesi i publikut në procesin e konsultimit publik vijon të jetë ende i ulët. Megjithatë konsultimi përmes formave të tjera të konsultimit (takime online/postë elektronike) kanë lejuar pjesëmarrjen e më shumë aktorëve në proces dhe ka rezultuar më i vlefshëm.

2.4. Palët e interesuara të përfshira

2.4.1. Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarëtë caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?

Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021-2027”. Hartimi i Strategjisë ka filluar me ngritjen e Grupit të Punës me datë 5.2.2022 dhe është hartuar me mbështetjen e ekspertëve të GIZ. Kohëzgjatja e përgjithshme e hartimit të strategjisë përfshirë konsultimet e vazhdueshme gjatë hartimit dhe konsultimin publike ka qenë nga data 30.07.2021 deri më 04.05.2022. Në këtë afat përfshihen edhe takimet me grupet e interesit, komunikimet me postën elektronike edhe konsultimi përmes regjistrimit elektronik. Procesi i hartimit ka qenë shumë dinamik dhe grupet e interesit që kanë qenë të përfshira në hartimin e dokumentit komentet/sugjerime e tyre janë marrë parasysh gjatë procesit të hartimit.

Projektligji “Për Bletarinë”.

Hartimi i projektligjit është iniciuar me kërkesën e vazhdueshme të Federatës së Bletërritësve të Shqipërisë dhe Shoqatave lokale të tyre, në të gjitha takimet dhe aktivitetet që zhvilloheshin me ministrin e bujqësisë për sektorin e bletarisë, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për këtë sektor me rëndësi jetike, si dhe përcaktimin e rregullave dhe kushteve të regjistrimit, transportit, shtegtimit, mbrojtjes dhe kontrollit të produkteve të bletarisë. Percec konsultimi elektronik, përmes Regjistrimit Elektronik, RENJK, nga 24.4.2022 deri në datë 23.5.2022; është realizuar edhe komunikimi përmes postës elektronike gjatë gjithë fazës së hartimit të draftit të projektligjit; takime të vazhdueshme (edhe online) me ekspertët e fushës; takime të vazhdueshme të grupit të punës; marrja e mendimeve nga ministrinë e linjës.

2.4.2. Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)

1. Struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës për *Projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021-2027”* ka qenë:

- Përfaqësues të drejtorive të MBZHR-së, AKU, AKVMB, etj.;
- Përfaqësues të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
- Përfaqësues të Univesitetit Bujqësor;
- Përfaqësues të Grupeve të interesit, si më poshtë:
 - Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar
 - ANRD – Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural;
 - ADAD Malore;
 - AFI – Albanian Food Industri;
 - ADAMA – Shoqata Shqiptare e Qumështit dhe Mishit;

Projektligji “Për bletarinë

Struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës për këtë projektligji janë:

- Shoqatat e Bletërritësve Lokalë, Korçë, Vau i Dejës;
- Federata e Bletërritësve të Shqipërisë;
- Profesorë të Universitetit Bujqësor të Tiranës, si dhe Universitetit Aleksandër Xhuvani Elbasan;
- Gazetarë;

2.4.3. Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultimet e hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?

Gjatë procesit të konsultimit për projektvendimin e konsultuar gjatë vitit 2022, kanë marrë pjesë 6 palë të interesuara, nga të cilët dhënë komente/sugjerime me qëllim përmirësimin e projektaktit.

2.4.4. Cila ishte struktura e kontribuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?

Struktura e kontribuesve në konsultimin publik për projektvendimin e konsultuar është:

Për *Projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021-2027”*

- Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar
- ANRD – Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural;
- ADAD Malore;
- AFI – Albanian Food Industri;
- ADAMA – Shoqata Shqiptare e Qumështit dhe Mishit
- IBB – Instituti i Bujqësisë Organike

Për projektligjin “Për bletarinë”

- Shoqatat e Bletërritësve Lokalë, Korçë, Vau i Dejës;
- Federata e Bletërritësve të Shqipërisë;
- Profesorë të Universitetit Bujqësor të Tiranës, si dhe Universitetit Aleksandër Xhuvani Elbasan;
- Gazetarë;

2.4.5. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?

Vlerësojmë se situata në krahasim me vitet e kaluara për gjatë vitit 2022 është në të njëjtat nivele.

2.5. Rekomandimet dhe komentet e marra

2.5.1. Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdokonsultim?

Për projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021-2027” ky projektvendim është konsultuar Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar, ANRD – Rrjeti Shqiptar

për Zhvillimin Rural, ADAD Malore, AFI – Albanian Food Industri, ADAMA – Shoqata Shqiptare e Qumështit dhe Mishit dhe IBB – Instituti i Bujqësisë Organike. Nga ana e tyre janë bërë komente dhe sugjerime të cilat janë marrë parasysh gjatë procesit të hartimit.

Projektligji “Për bletarinë”, ky projektligj është konsultuar me Ø Shoqatat e Bletërritësve Lokalë, Korçë, Vau i Dejës; Federata e Bletërritësve të Shqipërisë; Profesorë të Universitetit Bujqësor të Tiranës, si dhe Universitetit Aleksandër Xhuvani Elbasan, Gazetarë;

2.5.2. Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?

Projektvendimi “ Për miratimin e Strategjisë për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021-2027” janë marrë 22 komente .

- 13 komente janë pranuar plotësisht
- 0 janë pranuar pjesërisht
- 9 janë refuzuar

Projektligji “Për Bletarinë” janë marrë 47 komente .

- 24 komente janë pranuar plotësisht
- 23 janë refuzuar

2.5.3. Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?

Vlerësojmë se situata në krahasim me vitet e kaluara është në të njëjtat nivele.

2.5.4. Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave tëmarra gjatë konsultimit publik?

Për projektligjet e konsultuara dhe miratuar në vitin 2022 nuk ka patur ndryshim të VNR-se.

2.6. Raportet mbi rezultatet e konsultimit

2.6.1. Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?

Janë hartuar dy raporte konsultimi publik për projektvendimin e konsultuar i cili është publikuar në Regjistrin Elektronik për njoftimet dhe Konsultimet Publike .

2.6.2. Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?

Për projektvendimin e konsultuar është publikuar.

<https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/450>

2.7. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksin e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)

1. Projektvendimi “ Për miratimin e Strategjisë për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Peshkimin 2021-2027”. 8
2. Projekligji “Për bletarinë”. 8
3. Projektligji “Për Përfundimin e procesit të privatizimit të objektveve të ish-Ndërmarrjeve Bujqësore”. sipas pikës 1, të Nenit 1 të ligjit “Për konsultimin Publik”, i nënshtrohet këtij procesi. 8

Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen (Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)

Sfidat kryesore që paraqet konsultimi publik lidhen më së shumti me gjithëpërshirjen e publikut në këtë proces. Ende nuk reflektohet një kulturë e angazhimit në proceset e hartimit të politikave. Megjithë përpjekjet dhe mundësitë e ofruara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ende nuk ka përfshirje aktive të publikut në procesin e dhënies së rekomandimeve apo qëndrimeve për përmbajtjen e projektakteve që hartohen. Për periudhën e ardhshme, me qëllim përmirësimit të procesit, organizimi i konsultimeve është planifikuar të orientohet edhe më shumë përmes informimit më aktiv të publikut për përfshirjen në procesin e konsultimit publik. Mendojmë se për të përmirësuar procesin e konsultimit publik dhe për të siguruar një përfshirje sa më të madhë të publikut në këtë proces, është e nevojshme dhe zhvillimi i trajnimeve mbi procesin e konsultimit publik për të gjithë punonjësit që merren me hartim legjislativ. Kjo do të mundësonte një njohje dhe përdorim edhe më të mirë e të shtuar të metodave gjatë procesit të konsultimit publik dhe rritjen e pjesëmarrjes së publikut në konsultimin e projektakteve.